

VENDIM
Nr.618, datë 8.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.90, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E ATASHEVE USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË SHËRBEJNË NË
PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, NË
SHTABET E NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET
USHTARAKE NDËRKOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e planifikuara për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Emërtimi	Paga në euro	Paga në dollarë	Shtesa për përfaqësimin (në%)
Përfaqësitë e NATO-s			
Gj. Lejtnant	1170	1410	75%
Gj. Major	1145	1365	60-75%
Gj. Brigade	1070	1285	60-75%
Përfaqësitë e tjera			
Kolonel	960	1165	40-60%
Nënkolonel	910	1100	40-60%
Major	865	1050	40%
Kapiten	805	1020	40%
Toger	760	925	40%
Nëntoger	705	875	40%
K/kapter	760	925	40%
Kapter	680	820	40%
Rreshter	580	680	40%
Tetar	470	575	40%
Nëntetar	420	520	40%